

## **Koordinimi i zhvillimit profesional me bazë në shkollë**

**Tipi i programit:** Plotësues

### **Hyrje:**

Kursi “**Koordinimi i zhvillimit profesional me bazë në shkollë**” është zhvilluar nga KEC, në kuadër të Programit për Arsimin Themelor, për të ndihmuar arsimin kosovar në zhvillimin e shkathtësive relevante të shekullit XXI tek nxënësit e shkollave fillore/të mesme të ulëta.

Kursi është hartuar nga një grup punues i udhëhequr KEC, me kontributin e koordinatorëve shkollorë për zhvillim profesional të mësimdhënësve nga 12 shkolla, ku është testuar koordinimi i zhvillimit profesional me bazë në shkollë. Gjithsej janë trajnuar 51 koordinatorë dhe anëtarë të ekipeve shkollore për zhvillim profesional.

**Përshkrimi i kursit:** Kursi “Koordinimi i zhvillimit profesional me bazë në shkollë” është konceptuar për t’u ofruar për koordinatorët shkollorë të zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe anëtarët tjerë të ekipit shkollor për zhvillim profesional të mësimdhënësve, në shkollat fillore/të mesme të ulëta dhe ato të mesme të larta. Programi është zhvilluar në përputhje të plotë me Kornizën e Zhvillimit Profesional me Bazë në Shkollë, e cila është miratuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Programi realizohet në formë të kursit treditësh, i cili ofrohet sipas formulës 1 + 1 + 1. Kjo nënkupton që ofrohet në tri ditë të ndara, në mes të cilave pjesëmarrësit marrin detyra për t’i kryer në shkollat e tyre. Kështu në mes të ditës së parë dhe të dytë pjesëmarrësit kanë për detyrë të bëjnë vlerësimin e nevojave për zhvillim profesional dhe të vijnë ditën e dytë me rezultatet nga ky vlerësim. Në mes të ditës së dytë dhe të tretë, pjesëmarrësit kanë për detyrë që në nivel shkolle të hartojnë planin për zhvillim profesional dhe ta prezantojnë në fillim të ditës së tretë. Pas përfundimit të kursit pjesëmarrësit koordinojnë (koordinatorët) apo ndihmojnë (anëtarët tjerë të ekipit shkollor) në koordinimin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve në shkollën e tyre.

**Qëllimi i kursit:** Qëllimi i kursit është që të aftësojë koordinatorët shkollorë të nivelit parauniversitar dhe anëtarët e ekipeve shkollore për zhvillim profesional, në planifikimin, koordinimin dhe monitorimin/vlerësimin e zhvillimit profesional me bazë në shkollë.

### **Rezultatet e të nxënit:**

Pas përfundimit të kursit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Njihen me kornizën ligjore që lidhet me zhvillimin profesional të mësimdhënësve;

- Kuptojnë modelet e ndryshme të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve;
- Përvetësojnë Kornizën e Zhvillimit Profesional me Bazë në Shkollë;
- Demonstrjnë shkathhtësi në vlerësimin e nevojave të zhvillimit profesional në shkollë
- Bëjnë analizën e nevojave për zhvillim profesional të mësimitdhënësve
- Shqyrtojnë në mënyrë kritike të gjeturat dhe përcaktojnë përparësitë në ZhPM
- Udhëheqin procesin e hartimit të planit të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve
- Tregojnë zotësi të planifikimit të aktiviteteve të zhvillimit profesional
- Kuptojnë rëndësinë e monitorimit dhe vlerësimit të procesit të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve

### **Implementimi i kursit (metoda, forma, dhe vendi):**

Kursi “Koordinimi i zhvillimit profesional me bazë në shkollë” do të realizohet si në vijim:

1. **Kursi treditësh (18 orë):** Në formë të punëtorive të fasilituara nga 2 fasilitatorë të aftësuar nga KEC. Secila nga tri ditët e kursit ka nga katër sesione pune 90 minutëshe.
2. **Puna në shkollë në hartimin e planit shkollor për zhvillim profesional të mësimitdhënësve (12 orë):** Pjesëmarrësit do të bëjnë punë praktike në identifikimin dhe analizimin e nevojave për zhvillim profesional të mësimitdhënësve në shkollë, në hartimin e draftit të planit shkollor për zhvillim profesional të mësimitdhënësve dhe në koordinimin e komunikimit të brendshëm në shkollë deri te versioni final i planit
3. **Koordinimi i zhvillimit profesional të mësimitdhënësve në nivel shkolle:** Pritet që pjesëmarrësit si koordinatorë apo anëtarë të ekipit shkollor për zhvillim profesional të mësimitdhënësve, në mënyrë të vazhdueshme të koordinojnë procesin e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve në shkollën e tyre.

### **Vlera e aktiviteteve të kursit e shprehur në orë për licencim dhe certifikim**

Ky kurs ka gjithsej 30 orë kredi, ndërsa kushtet për certifikim janë:

1. Pjesëmarrja me rregull në kurs, që nënkupton së paku 90% të kohëzgjatjes së kursit;
2. Koordinimi i punës në hartimin e planit shkollor për zhvillim profesional të mësimitdhënësve.